

## **Kushtet e pergjithshme te sigurimit E.A.R.**

**1.** Respektimi dhe plotesimi duhesisht i kushteve te kesaj Police nga ana e te Siguararit dhe vertetesia e deklaratave dhe e pergjigjeve qe i Siguruari ka dhene ne Pyetesorin dhe kerkesen e plotesuar prej tij, do te jene kusht paraprak per çdo pergjegjesi te Siguruesit.

**2.** Formulari dhe Seksionet do te konsiderohen te perfshira ne Police dhe pjese te saj dhe shprehja

" kjo Police ", kudo qe eshte perdorur ne kete kontrate, do te kuptohet se ne te jane perfshire Formulari dhe Seksionet. Cdo fjale ose shprehje se ciles i eshte dhene nje kuptim i caktuar ne ndonje pjese te kesaj Police ose te ketij Formulari ose te ketyre Seksioneve do te mbaje kete kuptim kudo qe te shfaqet.

**3.** I Siguruari, me shpenzimet e tij, do te marre te gjitha masat e nevojshme dhe do te veproje ne perputhje me te gjitha rekomandimet e duhura te Siguruesit per te parandaluar humbjen, demtimin apo pergjegjesine dhe per te zbatuar kerkesat ligjore dhe rekomandimet e prodhuesit.

**4. a )** Perfaqesuesit e Siguruesit do te kene te drejten qe te inspektojne dhe kontrollojne rrezikun ne çdo kohe qe do ta shohin te pershtateshme dhe i Siguruari do t'i jape perfaqesuesve te Siguruesit te gjitha detajet dhe informacionin e nevojshem per vleresimin e rrezikut.

**b )** I Siguruari do te njoftoje Siguruesin menjehere, me shkrim, per çdo ndryshim te rrezikut dhe, me shpenzimet e tija, do te marre te gjitha masat qe kerkojne rrethanat. Fusha e mbulimit dhe/ose primi, ne se eshte e nevojshme, do te ndryshojne ne pershtatje me kushtet e reja. Asnje ndryshim nuk do te behet nga i Siguruari kurdohere qe rreziku rritet, pa konfirmimin me pare me shkrim te Siguruesit per vazhdimesine e sigurimit.

**5.** Ne rast te ndodhjes se nje ngjarje qe çon ne nje kerkese per demshperblim sipas kesaj Police, i Siguruari do te :

**a )** njoftoje menjehere Siguruesin me shkrim, duke percaktuar natyren dhe shtrirjen e humbjes ose demit;

**b )** marre te gjitha masat brenda mundesive te tij per te minimizuar zgjerimin e humbjes ose demit ;

**c )** ruaje pjeset e prekura dhe vere ato ne dispozicion per inspektim perfaqesuesit te Siguruesit;

**d )** jape te gjithë informacionin dhe deshmite dokumentare qe mund te kerkoje Siguruesi ;

**e )** informoje autoritetet e policise ne rastin e humbjes ose demtimit qe rrjedh nga vjedhja.

Siguruesi, ne çdo rast, nuk do te jete pergjegjes per humbjen, demin ose pergjegjesine per te cilat nuk ka marre njoftim me shkrim brenda 14 diteve nga momenti i ngjarjes se sigurimit.

Me dhenien e njoftimit Siguruesit sipas ketij kushti, i Siguruari mund te kryeje riparimet ose zevendesimin e demeve me permasa te vogla dhe, ne te gjitha rastet e tjera, do t'i jepet mundesia nje pefaqesuesi te Siguruesit per te inspektuar humbjen ose demin me

pare se te kryhet çdo riparim ose ndryshim. Ne se perfaqesuesi i Siguruesit nuk kryen inspektimin brenda nje peridhe kohe qe mund te konsiderohet e mjaftueshme sipas rrethanave, atehere te Siguruarit i jepet e drejta te filloje riparimin ose zevendesimin. Pergjegjesia e Siguruesit, sipas kesaj Police, persa i perket çdo artikulli te demtuar, do te pushoje ne se artikulli i permendur nuk riparohet duhesisht e pa vonese.

**6.** I Siguruari, me shpenzimet e Siguruesit, do te kryeje dhe do te bashkeveproje ne kryerjen dhe do te lejoje te kryhen te gjitha ato veprime qe mund te jene te nevojshme ose te kerkuara nga Siguruesi ne interes te çdo te drejte ose mjeti, ose perfitimi te demshperblimit te pjeseshem ose te plote prej paleve ( perveç atyre qe jane te siguruara sipas kesaj Police) tek te cilat Siguruesi ka ose do te kete te drejten per t'u paguar ose perfituar nga çdo humbje ose dem sipas kesaj Police, ne se keto veprime ose çeshtje jane ose behen te nevojshme ose kerkohen para ose pas demshperblimit te te Siguruarit nga Siguruesi.

**7.** Mosmarreveshjet ndermjet Siguruesit dhe te Siguruarit, qe rrjedhin nga marrredheniet e sigurimit, do te zgjidhen nga gjykata e vendit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit.

**8.** Ne se kerkesa per demshperblim permban mashtrim, ose ne mbeshtetje te kerkeses eshte bere ose perdorur ndonje deklarim fals, ose nga i Siguruari ose dikush tjeter qe vepron ne emer te tij jane perdorur menyra apo mjete mashtruese per te perfituar sipas kesaj Police, ose ne se kerkesa per demshperblim eshte refuzuar dhe brenda 3 ( tre ) muajve nuk ka filluar asnje veprim ose padi ( procedure ), çdo perfitim sipas kesaj Police do te humbase.

**9.** Ne se ne momentin qe ndodh ngjarja e sigurimit sipas kesaj Police egziston nje mbulim tjeter per te njejten humbje, dem apo pergjegjesi, Siguruesi nuk do te jete pergjegjes per te paguar me shume se pjesa qe i takon ne kete humbje, dem apo pergjegjesi.

**10.** Pas çdo ndodhje te nje ngjarje sigurimi, si i Siguruari ashtu dhe Siguruesi, ka te drejten te zgjidhe kontraten e sigurimit. Zgjidhja mund te behet deri nje muaj pas perfundimit te bisedimeve per demshperblim duke i derguar njoftim me shkrim pales tjeter. Zgjidhja hyn ne fuqi nje muaj pasi te jete marre njoftimi nga pala tjeter.

**11.** Ne se kontrata e sigurimit zgjidhet nga i Siguruari, Siguruesi ka te drejte te mbaje primin e sigurimit per periudhen vijuese. ne se kontrata e sigurimit nderpritet nga Siguruesi, zbatohet parimi i mesiperm per sa i perket pjese se primit te sigurimit, qe i korespondon demshperblimit te paguar dhe pjeses se primit qe i korespondon periudhes se sigurimit perpara nderprerjes se kontrates.

## **Perjashtime te pergjitheshme**

Siguruesi nuk do te demshperbleje te Siguruarin ne lidhje me humbjen, demin ose pergjegjesine qe, ne menyre direkte ose indirekte jane shkaktuar, kane ardhur ose jane shtuar nga :

- a.** lufta, invazioni, veprimi i armikut te jashtem, veprimet ushtarake ( pavaresisht ne se lufta eshte shpallur ose jo ), lufta civile, rebelimi, revolucioni, revolta, kryengritja, trazira, greva, mbyllja e ndermarrjes, turbullira civile, grushti i shtetit, nje grup personash keqdashes ose personash qe veprojne ne emer te çdo organizate politike ose ne lidhje me te, konspiracioni, konfiskimi, komandimi, rekuizimi ose shkaterrimi ose demtimi me urdher te çdo qeverie de jure ose de facto ose te çdo autoriteti shteteror, eksodit ;
- b.** reaksioni berthamor, rrezatimi berthamor ose ndotja radioaktive ;
- c.** veprimi keqdashes ose pakujdesia e rende e te Siguruarit ose e perfaqesuesit te tij ;
- d.** nderprerja e plote ose e pjeseshme e punes.

Ne çdo padi, kerkese ose proçedure tjeter gjyqesore ku Siguruesi pohon qe, per arsye te klauzolave te perjashtimit **a** te mesiperm, çdo humbje, shkaterrim, dem ose pergjegjesi nuk eshte mbuluar nga ky sigurim, atehere barra per te provuar qe nje humbje, shkaterrim, dem ose pergjegjesi e tille eshte e mbuluar i bie te Siguruarit.